




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)



**RAPORTI NGA PROCESI I ORGANIZIMIT TË DËGJIMEVE PUBLIKE  
PËR DRAFT - STRATEGJINË PËR KOMUNIKIM DHE MARRËDHËNIE  
ME PUBLIKUN 2023 – 2026 DHE  
DRAFT - PLANI I VEPRIMIT PËR INFORMIM DHE KOMUNIKIM 2023-  
2026**

**Qershor, 2023**

## HYRJJE

Komuna e Klinës, viteve të fundit ka krijuar përvoja të vlefshme në aspektin e komunikimeve strategjike nga e kaluara.

Gjatë viteve të pasluftës ka avancuar në mënyrë sistematike në përmirësimin e spektrit ligjor, ndërsa kohëve të fundit ka përmirësuar dhe intensifikuar angazhimin e saj për një komunikim sa më të mirë me palët e interesit, e veçanërisht me qytetarët e Klinës. Gjatë përpjekjeve të komunës së Klinës për të komunikuar me qytetarët, ka organizuar fushata informuese, duke përdorur kryesisht mjetet tradicionale të komunikimit, me qëllim të mbajtjes së qytetarëve të informuar mbi zhvillimet në komunë dhe rreth saj. Format më të shpeshta të komunikimit kanë qenë postimet në vendet e dizajnuara për informim, takimet e drejtpërdrejta në mes të kryetarit të komunës dhe qytetarëve dhe komunikimeve nëpërmjet radios së vetme që ekziston në komunë. Po ashtu, komuna ka organizuar tubime publike të parapara me ligj. Përkundër përpjekjeve në rritje, pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje e diskutim të drejtpërdrejtë me komunën, edhe pse është në rritje kohëve të fundit, falë angazhimit të komunës, kërkon më shumë angazhim për të arritur në nivel të kënaqshëm.

Strategjia për Informim dhe Komunikim 2023-2026 është zhvilluar mbi aspiratat e komunës për të avancuar me hapa të shpejtë, duke përfutur nga avantazhet që ofrojnë zhvillimet e teknologjisë së informacionit dhe përdorimi i shtuar i medieve të reja si kanale të komunikimit. Përmes këtij dokumenti do të kërkohet një reagim proaktiv i audiencave ndaj aktiviteteve dhe projekteve të komunës, e për rrjedhojë edhe fuqizim të marrëdhënieve dhe ndërveprimit me qytetarë, media, organizata të shoqërisë civile, hisedarë dhe partnerë që mbështesin nismat e komunës.

Kjo do të arrihet përmes thellimit të praktikave të komunikimit me audiencat e brendshme dhe të jashtme duke përdorur kanale të përshtatshme dhe efikase të komunikimit. Së këndejmi, Strategjia për Informim dhe Komunikim 2023-2026 është e një rëndësie të veçantë, si për krijimin e urave të ndërveprimit me aktorë të ndryshëm, ashtu dhe për ngritjen e imazhit dhe reputacionit të komunës.

Pjesë integrale e kësaj strategjie është edhe komunikimi i brendshëm, si një komponentë që përqendrohet në përmirësimin e praktikave të komunikimit dhe rritjen e motivimit të të punësuarve në përmirësimin e performancës individuale, ekipore dhe organizative.

Bashkëpunimi, bashkërendimi dhe komunikimi efikas (si brenda drejtorive të caktuara, ashtu edhe ndërmjet tyre) si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve dhe marrëdhënieve në punë, përbëjnë parakushtet themelore për rritjen e motivimit dhe performancës në punë.

Me qëllim të krijimit të parakushteve për zbatimin e objektivave të Strategjisë për Informim dhe Komunikim 2023-2026, Komuna do të krijojë mundësi optimale për ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale të Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun,

kurse në raste të veçuara do të angazhojë edhe ekspertë të jashtëm, me qëllim të avancimit të nivelit të komunikimeve në administratën komunale.

Aktivitetet e parapara me këtë strategji janë dizajnuar mbi bazën e një analize gjithëpërfshirëse të proceseve dhe mekanizmave të komunikimit dhe efikasitetit të tyre në performancën e komunës në disa elemente kyçe. Mbi bazën e kësaj analize janë identifikuar mundësitë për përmirësim, të cilat janë përkthyer në objektiva, mesazhe dhe kanale të komunikimit dhe mekanizma për marrjen e informatave kthyesë.

## ECURIA E PROCESIT TË DËGJIMEVE PUBLIKE PËR DRAFT - STRATEGJINË PËR KOMUNIKIM DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN 2023 – 2026 DHE DRAFT - PLANI I VEPRIMIT PËR INFORMIM DHE KOMUNIKIM 2023-2026

Kryetari i Komunës së Klinës, në bashkëpunim me drejtorinë e Administratës si dhe Zyrën për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, duke respektuar UDHËZIMIN ADMINISTRATIV (MAPL) NR. 06/2018 PËR STANDARDET MINIMALE TË KONSULTIMIT PUBLIK NË KOMUNA, ka filluar procedurën e dëgjimeve publike të dokumenteve të lartcekura me themelimin e grupit punues, me gjithsej nëntë anëtarë.

Grupi punues me vendim të kryetarit të komunës 01 Nr. 112-38316/2022, ka hartuar planin e brendshëm të organizimit të debatit me publikun i cili është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal Klinë, më datë: 13.06.2023, duke filluar në ora 10:00.

Para datës së takimit, grupi punues ka nxjerrë njoftimet për të gjitha institucionet komunale, qytetarët, OJQ-të, organizatat e biznesit, kryetarët e fshatrave të bashkësive lokale, media dhe të interesuarit tjerë për pjesëmarrje në këtë takim, si dhe pjesëmarrjen me kërkesa dhe sugjerime në mënyrë elektronike tek zyrtarët:

1. Ahmet Berisha, email: [ahmet.berisha@rks-gov.net](mailto:ahmet.berisha@rks-gov.net)
2. Vlora Tafili, email: [vlora.tafili@rks-gov.net](mailto:vlora.tafili@rks-gov.net)

Gjithashtu dhe mundësinë e dorëzimit të propozimeve lidhur me këto akte me shkrim në shërbimin për punë të kuvendit, kati I, zyra e dytë.

Përveç takimit me publikun në sallën e Kuvendit Komunal, grupi punues ka shfrytëzuar metodën për konsultim me qytetarët prej 30 ditësh në ueb-faqen zyrtare të komunës dhe në platformën e konsultimit publik në nivel të qeverisë.

Komuna Klinë : <https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2023/05/Ftese-per-Debat-me-Publikun-13.06.2023.pdf>

Platformën e konsultimeve publike – Qeveria e Kosovës: <https://konsultimet.rks-gov.net/meetings.php?InstitutionID=20514&OpenPage=0&ClosedPage=0>

Materiali në formë fizike iu është mundësuar të gjithë të interesuarve të merret në Zyrën e Shërbimit për Punë të Kuvendit. Po ashtu, ka qenë i publikuar edhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Klinës si dhe në Platformën e Qeverisë së Kosovës për Konsultime Publike.

<https://kk.rks-gov.net/.../STRATEGJIA-PËR-KOMUNIKIM-DHE...>

<https://kk.rks-gov.net/.../PLANI-I-VEPRIMIT-PËR-INFORMIM...>

| Metodat e konsultimit                                        | Data / Kohëzgjatja | Numri i pjesëmarrësve | Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime |
|--------------------------------------------------------------|--------------------|-----------------------|----------------------------------------------------------|
| 1. Takim i drejtpërdrejtë në sallën e Kuvendit Komunal Klinë | 13.06.2023, 38 min | 18 pjesëmarrës        | 2 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa                   |
| 2. Publikimi në ueb faqe / platforma elektronike             | 30 ditë            | 2 pjesëmarrës         | 2 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesë për dokumentet    |

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizikë si dhe ato në formë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi Punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Draft - Strategjia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2023 – 2026 si dhe Draft - Plani i Veprimit për Informim dhe Komunikim 2023-2026, pas përmbylljes së procesit të konsultimit, do të finalizohen së bashku me komente dhe sugjerimet dhe do të procedohet për në Kuvendin e Komunës së Klinës për shqyrtim dhe miratim.

Shtojca nr. 1 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara.

| <b>Temat e dëgjimit</b>                                                                                                                       | <b>Kërkesat / Sugjerimet / Komentet</b>                                   | <b>Personi i kërkesës / sugjerimit për projektet</b>       | <b>Statusi i kërkesës / sugjerimi ( i pranuar , pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)</b> | <b>Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mospranimin të komenteve është i detyrueshëm)</b>                                                                                                                                                                                                   |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Draft - Strategjia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2023 – 2026 si dhe Draft - Plani i Veprimit për Informim dhe Komunikim 2023-2026 | Kërkesë për shpërndarjen e njoftimeve dhe lajmeve në kanalin <b>Viber</b> | Halil Bekaj- Zyrtar i IT-së në Komunën e Klinës.           | <b>Pranohet</b>                                                                                 | <b>Përgjigja:</b><br><br>Grupi punues ka pranuar kërkesën e zyrtarit, Halil Bekaj, gjatë fazës së konsultimit publik të dy dokumenteve dhe ka inkuadruar atë në Draft - Planin e Veprimit për Informim dhe Komunikim 2023-2026, dhe kjo platformë do të mundësojë që komuna të jetë më afër qytetarëve. |
| Draft - Strategjia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2023 – 2026 si dhe Draft - Plani i Veprimit për Informim dhe Komunikim 2023-2026 | Kërkesë për përfshirje të planit të konsultimeve në plan të veprimit.     | Mirsad Dakaj – Këshilltar i Kryetarit në Komunën e Klinës. | <b>Pranohet</b>                                                                                 | <b>Përgjigja:</b><br><br>Grupi punues ka pranuar kërkesën e Mirsad Dakaj – Këshilltar i Kryetarit, gjatë fazës së konsultimit publik sipas: <b>UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MAPL) NR. 06/2018 PËR STANDARDET MINIMALE TË KONSULTIMIT PUBLIK NË KOMUNA, Neni 12, pika 3. Plani i konsultimeve publike</b>    |

|                                                                                                                                               |                                                                                                                                         |                                        |                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|-----------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                                                                                                               |                                                                                                                                         |                                        |                 | <b>duhet të jetë pjesë përbërëse e planit për komunikim publik.</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| Draft - Strategjia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2023 – 2026 si dhe Draft - Plani i Veprimit për Informim dhe Komunikim 2023-2026 | Kërkesë për promovimin e veprimeve të qytetarëve aktiv të komunës së Klinës, të cilët i kontribuojnë vendit në të mirën e përgjithshme. | Ragip Kryeziu – Qyteti Klinë           | <b>Pranohet</b> | <p><b>Përgjigja:</b></p> <p>Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Ragip Kryeziu nga qyteti i Klinës, si qytetar aktiv për kujdes ndaj mjedisit.</p> <p>Veprimeve të tilla nga qytetarët aktivë, do të ju jepet hapësirë për promovim.</p>                                                                                                             |
| Draft - Strategjia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2023 – 2026 si dhe Draft - Plani i Veprimit për Informim dhe Komunikim 2023-2026 | Kërkesë për formimin e Këshillave Lokale.                                                                                               | Binak Gashi - Banor i fshatit Gremnik. | <b>Pranohet</b> | <p><b>Përgjigja:</b></p> <p>Grupi punues ka pranuar kërkesën e z. Binak Gashi nga fshati Gremnik, lidhur me formimin e Këshillave të Fshatrave, pasi që Komuna e Klinës është në proces të formimit dhe konsolidimit të këtyre mekanizmave mjaft të rëndësishëm, të cilët do të luajnë rol në përmirësim dhe lehtësim të komunikimit me qytetarë.</p> |

Gjatë debatit me publikun, lidhur me Draft - Strategjinë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2023 – 2026, si dhe Draft - Plani i Veprimit për Informim dhe Komunikim 2023-2026, pjesëmarrës në sallën e Kuvendit Komunal kanë qenë 18 persona.

Shtojca Nr. 2 – Tabela e numrit të pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

|         |    |
|---------|----|
| Femra   | 7  |
| Meshkuj | 11 |
| Total:  | 18 |

Kryesuesja e grupit punues:

Klinë, 27.06.2023

